


Pelikani kaçurrel

Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) është një prej shpendëve më të mëdhenj fluturues. Individët e rritur kanë ngjyrë gri në të bardhë, pendë kaçurrele në kokë, si dhe sqep me përmasa të mëdha që gjatë periudhës së riprodhimit merr një ngjyrë portokalli, apo të kuqe të ndezur. Pelikani kaçurrel folezon në zona të sheshta apo ishuj të gjendur në laguna të rrethuara me kallamishte.

Në Shqipëri, pelikani kaçurrel folezon vetëm në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, në një prej ishujve të gjendur në lagunën e Karavastës, ku popullata e këtij lloji për vite me radhë ka çelur të vegjlit. Kolonia e pelikanit në lagunën e Karavastës



ka qenë e qëndrueshme deri në vitet e para të dekadës 60', me 200-250 çifte folezuese. Për shkak të protestave dhe trazirave që përfshinë vendin tonë, kjo popullatë u cënua deri në atë pikë sa gati u zhduk, me vetëm 19 çifte folezuese.

Në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta gjenden rreth 100 çifte folezuese të këtij lloji.

Pelikani kaçurrel vrojtohet rregullisht edhe në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë, apo liqenet e Prespës, zona të cilat i përdor për t'u ushqyer dhe pushuar.



Statusi i pelikanit kaçurrel në Shqipëri



Flamingo

Flamingot (*Phoenicopterus roseus*) janë ndër llojet më tërheqës dhe karizmatik për njerëzit. Të rriturit kanë ngjyrë të bardhë me motive rozë, ngjyrë të cilën e marrin nga dieta e tyre e veçantë. Të rinjtë kanë ngjyrë gri në kafe. Flamingo vrojtohet gjatë gjithë vitit në numra të mëdhenj individësh pothuajse në çdo ligatinë të vendit tonë. Gjatë një dite në lagunën e Nartës mund të numërohen me mijëra individë të këtij lloji.

Flamingot kanë një strukturë shumë unike të qafës e cila është shumë fleksibël dhe merr formën e shkronjës S. Kjo strukturë i ndihmon flamingot gjatë procesit të ushqyerjes dhe pastrimit të pendëve.




Pelikani kaçurrel © PPNEA

Ruajtja e lagunave bregdetare është thelbësore për mbijetesën e popullatës së pelikanit, flamingos dhe shpendëve të tjerë të ujit.

Lagunat bregdetare sigurojnë një habitat të përshtatshëm ku shpendët e ujit mund të folezojnë, ushqehen e të pushojnë. Por, presioni i projekteve zhvillimore ka bërë që lagunat bregdetare të vendosen në rrezik.

Rreziqet e popullatës së pelikanit kaçurrel

- Tharja dhe degradimi i kënetave
- Shqetësimi gjatë periudhës së riprodhimit
- Elektroshoku dhe përplasja me linjat e energjisë



Bëhuni pjesë e përpjekjeve tona për ruajtjen e popullatës së pelikanit kaçurrel, flamingos dhe shpendëve të tjerë të ujit në Shqipëri.


Skano këtu dhe plotëso formatin e aplikimit.



In partnership with



Supported by




Ajencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Funded by the European Union



Embassy of the Federal Republic of Germany Tirana



Albania is Biodiversity